



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1163/1 Prot.

Tiranë, më 14 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 199, datë 14 . 08 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën nr. 167 Regj., datë 28.07.2025, të shtetasit R. G, kundër Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, z. R. G, në parashtrimet e paraqitura pranë Komisionerit, ndër të tjera, shprehet se:
“Më datë 1 prill 2025, Akademia e Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) shpalli konkurimin për vendin vakant të anëtarit të Asamblesë së ASHSH-së, nga fusha e Historisë.

Kjo është hera e dytë që unë marr pjesë në këtë proces, pasi edhe gjatë periudhës 2022-2023 kam konkuruar, por nuk arrita të përmbush objektivin, për shkak të parrgullsive të konstatuara në të gjithë hallkat e procedurës dhe në fazën përfundimtare të saj.

Këto parregullsi nuk i kam ndjekur përmes një procesi gjyqësor, por i kam paraqitur për shqyrtim pranë organeve administrative, si Ministria e Arsimit dhe Autoriteti kundër Diskriminimit, që nuk arriti të kuptojë dhe pranojë shpjegimin tim.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Sivjet, gjatë periudhës 4 (katër) mujore, nga 1 prilli 2025 deri më 14 korrik 2025, pas kryerjes së procedurave të aplikimit dhe pranimit të tyre, kam konstatuar një sërë shkeljesh procedurale, si dhe vendosjen time në kushte të pabarazisë në garë ndaj kandidatit rival, që ka vazhduar të mbajë postet drejtuese në institucion.

Për këtë arsye, përmes një sërë shkresash zyrtare të njëpasnjëshme, i jam drejtuar autoriteteve të Akademisë, duke kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e zbatrëzësive në aktet rregullatore, Rregulloren e procesit zgjedhor (që nuk ekziston), Skedën e indikatorëve të Performancës në korrespondencë me kriteret e ligjit dhe Statutit, mbi kushtet që duhet të plotësojë një kandidat, vendosjen e kushteve të barazisë në konkurim, në aspektin administrativ, mospranimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj dhe statut, si dhe zbatimin me përgjegjësi të të gjitha procedurave, përfshirë transparencën dhe informimin.

Në pothuajse asnjë rast nuk kam marrë përgjigje, ndërsa në ato pak raste kur kam marrë një reagim, ajo ka qenë prgjithsisht evazive, nuk jepte përgjigje për asnjë prej kërkesave të larërmendura dhe mund të konsideroheshin jashët kontekstit të çështjeve thelbësore që lidhen me të drejtën dhe zbatueshmërinë e saj.”

Subjekti ankues pretendon se ka evidentuar shkelje të rënda procedurale dhe thelbësore, si më poshtë citohet:

1. Mungesa e rregulloreve dhe procedurave zgjedhore – Akademia e Shkencave nuk ka miratuar asnjë rregullore të përgjithshme (apo qoftë edhe një rregullore ad hoc) për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të rinj. Kjo është minimalja e nevojshme për të siguruar një proces të drejtë dhe të ndershëm; mungesa e këtyre rregullave cënon parimet themelore kushtetuese dhe statutoare.
2. Mungesa e përcaktimit të mënyrës së votimit për anëtarët “Emeritus” – Nuk është parashikuar qartë procedura e administrimit të votës së akademikëve “Emeritus” (të cilët nuk marrin pjesë fizikisht). Konkretisht, mungojnë rregullat për mënyrën e votimit në distancë, dërgimin e votave me postë dhe ruajtjen e tyre me garanci nga palët e interesuara.
3. Mungesa e kriterëve të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve – Nuk është hartuar një rregullore me indikatorët e performancës, kriteret dhe sistemin e pikëzimit për vlerësimin e secilit kandidat. Kjo do të kishte garantuar një shqyrtim objektiv të kualifikimeve sipas kërkesave statutoare. Në fakt, vlerësimi i kriterëve statutoare nuk është kryer në themel as edhe gjatë mbledhjes së Komisionit të Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Juridike më 4 korrik 2025. Hartimi i kriterëve të performancës duhej të bazohej në nenet e Statutit dhe të pasohej nga verifikimi konkret i botimeve dhe veprimtarisë shkencore të secilit kandidat – gjë që mungoi plotësisht.
4. Pjesëmarrja e paaautorizuar e kandidatit rival (papajtueshmëri) – Kandidati rival, z. H. K, ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë me kandidimin, pasi nuk është dorëhequr nga detyrat e

tij drejtuese gjatë periudhës së konkurrimit. Që nga data 1 prill 2025 e deri pas përfundimit të garës, ai vazhdoi të mbante pozicionet: Drejtor i Institutit të Historisë, Kryetar i Këshillit Shkencor dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve të Instituteve Albanologjike. Mbajtja e këtyre posteve gjatë fushatës zgjedhore cenon drejtpërdrejt parimin e barazisë në garë dhe krijon influencë të padrejtë institucionale në proces. Sipas statutit të Akademisë, kandidatët duhet të mos kenë konflikte të tilla interesi; injorimi i kësaj papajtueshmërie e bën procesin të parregullt.

5. Mospublikimi i rregullave të konkurrimit nga Komisioni Zgjedhor – Edhe pas konstituimit të Komisionit Zgjedhor, nuk u hartua dhe as u komunikua për palët ndonjë rregullore specifike që të rregullonte procedurën e konkurrimit (afatet, mënyrën e votimit, administrimin e votave në distancë, etj.). Komisioni Zgjedhor, në mungesë të udhëzimeve ekzistuese, duhej vetë të përcaktonte rregullat e procesit dhe t'i bënte publike ato, për të siguruar transparencën dhe informimin e barabartë të të gjithë kandidatëve. Kjo detyrë nuk u krye. Ashtu sikurse edhe sot e kësaj dite, edhe pse votimi ka përfunduar, unë nuk kam pothuajse asnjë informacion zyrtar mbi performancën time, sa vota kam marrë, si janë shpërndarë votat, si është kryer votimi, kush janë pjesëmarrësit me dy lista votuesish, si është bërë përlllogaritja e kuorumit, si është llogaritur 2/3, a është bërë ajo në përputhje me ligjin, sa vota abstenimi ka pasur, si janë llogaritur ato.
6. Mungesa e transparencës ndaj ankuesit – Gjatë gjithë kohës së konkurrimit, Akademia e Shkencave nuk i ka vënë në dispozicion ankimuesit R. G, asnjë nga informacionet e kërkuara prej tij lidhur me procedurën. Ankimuesi, me shkresa të njëpasnjëshme drejtuar Kryetarit të Akademisë dhe komisioneve përkatëse, ka kërkuar informacione dhe garantimin e rregullshmërisë së procesit. Institucioni i ASHSH-së, nuk ka dhënë asnjë përgjigje ndaj këtyre kërkesave, duke cenuar të drejtën e informimit dhe të mbrojtjes së interesave të tij gjatë garës. (Vlen të theksohet se dokumentet kryesore zgjedhore – p.sh. procesverbalet – ndodhen vetëm nën kontrollin e Akademisë dhe ankuesi nuk ka mundur t'i sigurojë).

Subjekti ankues, parashtroi se, sipas këndvështrimit të tij, ASHSH:

- Ka shkelur hapur parimet kushtetuese të së drejtës për pjesëmarrje të barabartë, barazi para ligjit, proces të rregullt dhe transparencë institucionale, të garantuara nga nenet 18, 42, 48 dhe 49, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Operon në mungesë të plotë të akteve rregullatore të brendshme, nuk ka miratuar një rregullore për zgjedhjet, siç kërkohet nga çdo institucion publik, dhe nuk i është referuar asnjë baze të qartë procedurale në procesin e përzgjedhjes;
- Vepron si një strukturë jashtë kontrollit të ligjit, në mënyrë arbitrare, duke zhvilluar “zgjedhje” të manipuluar, pa verifikim ligjor të votave, me fletë votimi të sjella me automjetin personal të Kryetarit, në mungesë të çdo sigurie, verifikimi, apo transparence;

- Nuk i nënshtrohet auditimit të performancës institucionale, nuk ka indikatorë për vlerësimin e vëprimtarisë, nuk i jep llogari askujt, dhe në mënyrë faktike ka ndërtuar një realitet juridic parallel, që sfidon vetë ekzistencën e rendit ligjor në Republikën e Shqipërisë;
- Ka shpallur fitues një kandidat, pa përmbushur kriterin statutor të dy të tretave të votave, duke vendosur një precedent të rrezikshëm për të drejtën e qytetarëve për konkurim të ndershëm e të ligjshëm;
- Refuzon t'i përgjigjet kërkesave për informacion, nuk publikon aktet e veta, nuk garanton transparencë dhe nuk është e regjistruar si autoritet publik i detyruar të zbatojë ligjin për të drejtën e informimit.

Lidhur me pretendimet për parregullsi të tjera në administrimin e votave dhe rezultatit të këtij procesi, pala ankuese, vijon si më poshtë citohet;

“Gjatë procesit të votimit, veçanërisht në mënyrën e mbledhjes së votave në distancë (të akademikëve “Emeritus” ose të tjerëve joprezentë), ka pasur keqadministrim serioz, duke vënë në dyshim autenticitetin dhe integritetin e rezultatit. Konkretisht:

Marrja dhe ruajtja e votave në distancë pa garanci ligjore: Votat e akademikëve që nuk ishin të pranishëm fizikisht (p.sh. akademikë “Emeritus”) u tërhoqën dhe u administruan në kundërshtim me rregullat e zakonshme të votimit në distancë. Nuk pati asnjë transparencë apo dokumentacion zyrtar për mënyrën si u mbledhën këto vota. Vetëm një korrier i administratës së Akademisë është angazhuar për t'i mbledhur fizikisht votat, pa praninë e përfaqësuesve të palëve dhe pa ndonjë verifikim të pavarur. Votat nuk u dërguan me postë të regjistruar (siç do të ishte e udhës), nuk u protokolluan zarfe me vulë zyrtare shtetërore apo firma të marrjes në dorëzim – në thelb, mungon çdo gjurmë që do të provonte origjinalitetin e këtyre votave. Kështu, procedura e marrjes së votave në distancë ka qenë e papërshtatshme, e padefinuar në asnjë akt zyrtar, dhe pa asnjë masë për ruajtjen e fshehtësisë dhe integritetit të votës.

Transportimi i paligjshëm i fletëve të votimit: Pas mbledhjes së këtyre fletëve votimi nga shtëpitë e akademikëve, ato u transportuan dhe u ruajtën nga vetë administrata e Akademisë deri ditën e votimit, pa asnjë bazë ligjore dhe jashtë çdo garancie. Ky mënyrë veprimi cenon rëndë sekretin dhe sigurinë e votës, pasi nuk dihet nëse gjatë transportit ose ruajtjes votat mund të jenë cënuar, zëvendësuar apo manipuluar.

Manipulimi i numrit të votuesve dhe humbja e gjurmueshmërisë së votave: Gjatë seancës zgjedhore përfundimtare, votat e marra në distancë u përzier me votat e tjera, duke e bërë të pamundur dallimin se cilat fletë erdhën nga korrieri. Konkretisht, fletët e votimit të sjella nga jashtë (përmes korrierit të administratës) u futën një e nga një në kutinë e përgjithshme të votimit, së bashku me votat e hedhura aty nga anëtarët e pranishëm në sallë. Kjo praktikë – tundja e kutisë së votimit pas shtimit të fletëve të ardhura – u justifikua kinse për të ruajtur fshehtësinë, por në fakt fshihi çdo gjurmë të origjinës së 17 votave të jashtme. Kështu, u bë e pamundur të dihet nëse ato vota u trajtuan në përputhje me rregullat, ishin të njejtat që sollën në atë mënyrën e parregullt votuesit apo nëse numri i tyre ishte ai i deklaruarit realisht. Ky veprim është i pangjashëm, bie ndesh me

parimet kushtetuese dhe standardet e zgjedhjeve në Shqipëri, krijon dyshime serioze mbi integritetin e rezultatit dhe bie ndesh me çdo standard të administrimit të drejtë të votimit.

Shkelja e kriterit të kuorumit dhe vlefshmërisë së zgjedhjes (mbledhja e Asamblesë më 14.07.2025)

Nga të dhënat zyrtare të procesit zgjedhor të datës 14 korrik 2025, rezulton se në mbledhjen e Asamblesë morën pjesë fizikisht 31 akademikë. Ndërkohë, 17 fletë votimi të tjera ishin mbledhur paraprakisht (nga Kryetari i Akademisë, përmes korrierit të administratës) nga akademikë që nuk ishin prezent. Pas përfundimit të votimit nga të pranishmit, këto 17 fletë u futën në kutinë e votimit, duke e çuar numrin total të votave të hedhura në 48. Më pas, kutia u përzie (u tund) dhe u vijua me numërimin e përgjithshëm të votave.

Duhet theksuar se, sipas kuadrit ligjor dhe statutor, zgjedhja e një anëtarit “akademik” në rast kandidimi të drejtpërdrejtë kërkon një kuorum cilësor prej 2/3 të votave. Konkretisht, neni 6, pika 2 i ligjit nr. 53/2019 (i përditësuar) parashikon: “Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë, kandidati duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se 2/3-ve të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë.” Po kështu, neni 7, pika 11 i Statutit të Akademisë përcakton se kandidati që konkurren drejtpërdrejt quhet i zgjedhur vetëm nëse merr votat “pro” të 2/3 të anëtarëve të Asamblesë (duke përjashtuar vetëm akademikët “Emeritus” jopjesëmarrës në votim).

Në këtë rast, Asambleja e Akademisë, përdatën 14 korrik 2025, duhe të llogariste numrin total të diktuar nga ligji në gjithsej 49 anëtarë, duke llogaritur 31 të pranishëm në sallë, 17 votues me korrier të kryetarit dhe një Akademik që nuk u paraqit fare në votim, por që ligja, neni 6, pika 2 dhe statuti, neni 7 pika 11, praktika e deritanishme, e detyron në përllogaritje. Pra, 49 është ky numër i përllogaritjes për nxjerrjen e 2/3. Pragu i 2/3-ve të 49 anëtarëve është 33 vota. Rezultati i votimit, sipas procesverbalit, ishte: 32 vota për kandidatin H. K, një numër më i ulët se minimumi ligjor prej 33 votash; Unë paditësi (kandidati tjetër) mora më pak vota, dhe kishte gjithashtu 3 vota abstenim. (nuk kam ende asnjë përgjegje dhe asnjë njoftim zyrtar për rezultatin e saktë të arritur nga unë, as mbi dy listat e pjesëmarrësve ndonëse e kam kërkuar me email zyrtar). Asnjë kandidat, pra, nuk arriti pragun e 2/3 të anëtarëve të Asamblesë. Në takimin zyrtar të realizuar dje në zyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, S. Gj, në prani në Nen-Kryetarit V. T, A. H dhe G. H, Kryetari më deklaroi se ju R. G keni marrë 16 vota në sallë, H. K 15 vota në sallë, ndërsa keni marrë 0 vota nga ato me korrier të zyrës së tij dhe K 17 vota. Asnjë shpjegim se si Kryetari i Akademisë e din këtë ndarje, edhe pse u pyet. (Procesi i kompromentuar dhe i përkundërt me parimet kushtetuese)

Në kundërshtim flagrant me këtë rezultat dhe me kërkesat e sipërcituara statutore, Komisioni i Zgjedhjeve shpalli fitues kandidatin H. K me 32 vota, shifer kjo që përbën rreth 65% të numrit total të anëtarëve (49) – pra dukshëm më pak se 66.66% evotave të kërkuara. Ky veprim bie ndesh me normën imperative për vlefshmërinë e zgjedhjes dhe përbën një precedent të rrezikshëm të shkeljes së kriterit ligjor në përzgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Së fundi, vlen të vihet në dukje se i gjithë votimi u zhvillua në mungesë të garancive të barazisë midis kandidatëve: nuk u lejua vëzhgues të pavarur në proces, paditësi vetë nuk u lejua të ishte i pranishëm gjatë numërimit, dhe në tërësi procedura dukej e kompromentuar dhe e paracaktuar në favor të kandidatit tjetër i cili mban disa poste drejtuese. Këto rrethana e bëjnë edhe më të dyshimtë rezultatin e shpallur.

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, në tërësinë e tyre, përbëjnë shkelje të parimeve të shtetit të së drejtës, cenim të barazisë së pjesëmarrësve në konkurrim dhe shkelje të garancive themelore për një proces të rregullt ligjor. Si të tilla, ato çojnë në pavlefshmërinë absolute të aktit përfundimtar (zgjedhjes së shpallur) dhe të gjithë procedurës që i parapriu.

Pyetja është cila është arsyeja e kësaj sjellje dhe ku qëndron diskriminimi im? Mendoj se ka të bëjë së pari, me gjendjen arsimore, ndaj do të parashtroj gjendjen time arsimore, produktin shkencor të arritur në gati 4 (katër) dekada pune të pandërprerë, ndaj do të përqendrohem tek gjendja arsimore dhe ana ime profesionale.

Në mëbshtetje të kësaj ankese, dëshiroj të theksoj se vendimmarrja e institucionit përkatës për të mos më përzgjedhur në pozicionin e anëtarit të Asamblesë së ASHSH-së, në një proces të mbyllur dhe jo meritokratik, përben një akt diskriminues që më ka vendosur në pozitë të pabarabartë për shkak të statusit tim profesional, të formimit akademik, të produktit shkencor dhe të qëndrimit të pavarur ndaj strukturave të vendimmarrjes.

Unë, Prof. R. G, kam një përvojë 39-vjeçare në arsimin e larët dhe kërkimin shkencor (1986-2025). Kam mbajtur funksione të larta akademike dhe drejtuese, jam autor i një numri të konsiderueshëm veprash shkencore dhe kam dhënë mësim për dekada në universitetet më të rëndësishme të vendit. Që prej vitit 2007 titullin shkencor “Profesor” dhe, prej gjashtë vitesh jam punonjës shkencor pranë Departamentit të Historisë Bashkëkohore në Institutin e Historisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) dhe pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Gjatë karrierës time kam kontribuar në mësimdhënie dhe kërkime në fushën e historisë modern të Shqipërisë, të drejtës publike dhe institucioneve shtetërore. Kam qenë themelues dhe drejtues i strukturave akademike në Universitetin e Shkodrës, Universitetin Europian të Tiranës, etj.

Kam kryer studime postdoktorale në London School of Economics (LSE) – pranë Centre for the Study of Global Governance (2005, 2006, 2010) – si dhe kam qenë Visiting Research Fellow pranë Departamentit të Historisë Ndërkombëtare në LSE (gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024). Gjithashtu kam zhvilluar leksione dhe kërkime në universitete prestigjioze jashtë vendit, si University of London, Karl Franzens Universität Graz, Università degli Studi di Bari, Università di Padova, Istituto Trentino di Cultura, dhe Central European University, ndër të tjera.

Fushat kryesore të kërkimit shkencor: Fokus kryesor kam historinë politike të Shqipërisë gjatë shek. XX, me vëmendje të veçantë mbi proceset e shtetformimit, marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë dhe evolucionin e regjimeve politike.

Jam autor i mbi 55 artikujve shkencorë në periodikë brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, ai ka botuar tekste universitare të rëndësishme (p.sh. “Historia e Kohës së Re, Qytetërimi Perëndimor

1775–1815” (2000); “Historia e Kohës së Re 1815–1918” – bashkautor, 2004; “Hyrje në Studimin e Historisë” (1998); “Hyrje në të Drejtën Publike”; “Historia e Institucioneve Perëndimore”).

Jam autor i 8 monografive kërkimore me vlerë të veçantë akademike, ndër të cilat mund të përmenden: “Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës së vitit 1911” (2002), “Shqipëria dhe Çështja Shqiptare pas Luftës së Parë Botërore, 1918–1921” – botimi i parë 2007; botimi i dytë i rishikuar dhe i zgjeruar, 2013, “Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë, 1913–1914” (UET Press, 2011), “Shqipëria, 1911–1914” (2012), “Shqipëria dhe Tokat e Lirue, 1939–1946” – botimi i parë 2018; botimi i dytë i rishikuar (përfshirë hulumtime të reja mbi periudhën 1939–1944 dhe analizë të zgjeruar të viteve 1945–1946), ribotuar në 2023, “Shqipëria në Luftën e Madhe, 1914–1918” (dorëzuar për botim pranë Akademisë së Shkencave, dhjetor 2024 – në proces botimi), “Versailles Order and the Making of Albania, 1918–1926” (botim në gjuhën angleze, Peter Lang Academic Publishers – në redaktim final). Jam hartues i një sërë tekstesh universitare, etj.

Ky portofol i gjerë shkencor, i mbështetur në kërkime arkivore, botime të standardit ndërkombëtar dhe kontribute origjinale në fushën e historiografisë, është një produkt i një nagazhimi të pandërprerë akademik që përmbush dhe tejkalon çdo standard të kërkuar për përfqësim në institucionet shtetërore më të larta të vendit.

Në kontrast të thellë me këtë përvojë të dokumentuar, procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Asamblesë së ASHSH-së, në korrik 2025, u krye në një mënyrë që nuk respektoi as kriteret e meritës, as parimin e barazisë në trajtim, dhe as garancitë për një procedurë transparente dhe objektive. Kandidatura ime u përjashtua pa asnjë analizë cilësore të dosjes sime shkencore dhe pa një krahësim real me kandidatët e tjerë, shumë prej të cilëve nuk zotëronin një nivel të krahasueshëm për sa i përket titujve akademikë, produktit shkencor apo përvojës institucionale.

Kryetari i ASHSH-së, vetë ka në të gjithë jetën akademike vetëm 6 artikuj shkencorë. Për pasojë, jam vendosur në një pozitë të pabarabartë në raport me kolegë që janë përfshirë në procese vendimmarrëse pa një garë të drejtë e transparente, duke më mohuar mundësinë për trajtim të barabartë dhe përfaqësim të merituar, siç parashikohet në Kushtetutë dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për të gjitha sa më sipër, kërkoj nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të verifikojë këtë rast dhe të konstatojë shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë për shkak të pozitës sime akademike, qëndrimeve të mia publike dhe pavarësisë së mendimit, duke rekomanduar masat përkatëse për rivendosjen e së drejtës dhe për garantimin e një praktike institucionale të bazuar në meritokraci dhe integritet profesional.

Në këtë kuadër duke përdorur metodologjinë krahasuese, është e domosdoshme të përmendet se kandidati tjetër në këtë konkurim, z. H. K, në një periudhë të barazvlefshme pune në Institutin e Historisë (1986-2025), ka në bilancin e tij vetëm 2 monografi individuale. Pjesa tjetër e veprimtarisë së tij përbëhet nga bashkëpunime dokumentare, kumtesa të ripërsëritura dhe përmbledhje kolektive, të cilat, sipas standardeve të kërimit shkencor të pranuar ndërkombëtarisht, nuk përbëjnë prodhim original individual, dhe nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 4/2, të thirrjes së shpallur

nga vetë ASHSH, që kërkon kontribut të qartë individual dhe origjinalitet shkencor në fushën përkatëse si dhe kriterin e botimeve ndërkombëtare.

Ndërkohë, produkti im shkencor përfshin gjithë sa më sipër cituar prej meje.

Vendimmarrja që favorizon kandidaturën më të dobët në dëm të kandidaturës që përfaqëson shtandartin më të lartë shkencor, përbën një formë të pastër diskriminimi institucional. Kjo vendimmarrje nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse si një akt diskriminimi institucional për shkak të përkatësisë sime jashtë strukturave vendimmarrëse, për shkak të pozicionimeve të mia të pavarura në jetën akademike dhe publike, si dhe për shkak të standardeve të mia profesionale, që kanë qenë shpeshherë në kundërshtim me konformizmin që karakterizn strukturat aktuale të Akademisë.

Kam arsye të besoj se ndaj meje është aplikuar një diskriminim i tërthortë, i cili lidhet me mospërfshirjen time në rrjetet klienteliste që ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë mbi proceset zgjedhore, duke përjashtuar figurat që përfaqësojnë cilësi të lartë, mendim të pavarur dhe përvoja të konsoliduara ndërkombëtare.”

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, si vijon:

- Konstatimin e diskriminimit;
- Shpalljen të pavlefshëm të çdo rezultati të arritur me mjetet dhe metodat e lartpërmendura;
- Ripërsëritjen e konkurimit;
- Respektimin e kriterëve të vendosura nga ligji për kandidatët, duke mos anashkaluar asnjë prej tyre, sikurse e kërkon ligji;
- Hartimin e rregullave dhe procedurave të sakrta dhe të qarta të procesit të konkurimit, të indikatorëve të performancës, të vlerësimit dhe të votimit;
- Të vendoset në dispozicion i gjithë dokumentacioni zgjedhor, rezultat dhe metodologjia e përdorur, dhe mbi të gjitha verifikimi i plotë i videos së të gjithë procesit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë,

që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, është dhe kërkesë-padia drejtuar Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, me paditës: subjektin ankues, z. Romeo Gurakuqi dhe subjekt të paditur, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për shkelje të parimit të barazisë dhe trajtimit të pabarabartë e të pafavorshëm krahasuar me konkurentin H. K, në procedurën e konkurimit, të zhvilluar më datë 14 korrik 2025, për përzgjedhjen e anëtarit të ASHSH-së, në fushën e Historisë, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte, rrethana dhe kërkime, që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, bëhen prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës, duke paraqitur respektivisht si vijon:

“Objekti i padisë:

- 1. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të procedurës së konkurimit për përzgjedhjen e anëtarit të Akademisë së Shkencave në fushën e Historisë, e zhvilluar më 14 korrik 2025, për shkak të shkeljeve të rënda të parimeve kushtetuese, Statutit të Akademisë dhe rregulloreve zgjedhore.*
- 2. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve të Akademisë së Shkencave (komunikuar me shkresën nr. 850/3, datë 16.07.2025), që shpalli fitues kandidatin H. K, për shkak të shkeljeve thelbësore të rregullave të votimit dhe ndikimit të paligjshëm institucional në rezultat.*
- 3. Detyrimin e palës së paditur, Akademisë së Shkencave, për përsëritjen e procesit të konkurimit për vendin vakant në fushën e Historisë, në mënyrë të ligjshme, të paanshme dhe transparente.*
- 4. Vendosjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve (shpallur me shkresën nr. 850/3, datë 16.07.2025) dhe duke ndaluar konstituimin e z. H. K si anëtar i Akademisë së Shkencave, deri në përfundim të gjykimit, me qëllim shmangien e pasojave të parikthyeshme.*

Më datë 1 prill 2025, Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpalli konkurrimin publik për vendin vakant të anëtarit të saj nga fusha e Historisë. Kjo është hera e dytë që marr pjesë në këtë proces, pasi edhe gjatë periudhës 2022–2023 kam konkuruar, por nuk arrita të përmbush objektivin për shkak të parregullsive të konstatuara në të gjitha hallkat e procedurës dhe në fazën përfundimtare të saj. Këto parregullsi nuk i kam ndjekur përmes një procesi gjyqësor, por i kam paraqitur për shqyrtim pranë organeve administrative, si Ministria e Arsimit dhe Autoriteti Kundër Diskriminimit.

Gjatë periudhës katërmujore, nga 1 prilli deri më 14 korrik 2025, pas kryerjes së procedurave të aplikimit, kam konstatuar një sërë shkeljesh procedurale, si dhe vendosjen time në kushte të pabarazisë në garë ndaj kandidatit rival. Për këtë arsye, përmes një sërë shkresash zyrtare të njëpasnjëshme, i jam drejtuar autoriteteve të Akademisë, duke kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e zbrazëtirave në aktet rregullatore, vendosjen e kushteve të barazisë në konkurrim, mospranimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga ligji dhe statuti, si dhe zbatimin me përgjegjësi të të gjitha procedurave, përfshirë transparencën dhe informimin.

Në pothuajse asnjë rast nuk kam marrë përgjigje, ndërsa në ato pak raste kur kam marrë një reagim, ai ka qenë përgjithësisht evaziv dhe jashtë kontekstit të çështjeve thelbësore që lidhen me të drejtën dhe zbatueshmërinë e saj”.

Konstatohet se, nga këqyrja e kërkesë padisë së depozituar në Gjykatë, ankuesi, të njëtat fakte, rrethana, parashtrime dhe pretendime lidhur me:

- “Shkeljet procedurale në organizimin e procesit zgjedhor;
- Mungesën e rregulloreve dhe procedurave zgjedhore;
- Mungesën e përcaktimit të mënyrës së votimit për anëtarët “Emeritus;
- Mungesën e kriterëve të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;
- Pjesëmarrjen e paautorizuar e kandidatit rival (papajtueshmëri);
- Mospublikimin e rregullave të konkurrimin nga Komisioni Zgjedhor;
- Mungesën e transparencës ndaj paditësi;t
- Parregullsitë në administrimin e votave dhe rezultatit, keqadministrim serioz, duke vënë në dyshim autenticitetin dhe integritetin e rezultatit;
- Marrjen dhe ruajtjen e votave në distancë pa garanci ligjore;
- Transportimin e paligjshëm i fletëve të votimit;
- Shkeljen e kriterit të kuorumit dhe vlefshmërisë së zgjedhjes (mbledhja e Asamblesë më 14.07.2025;)
- I gjithë votimi u zhvillua në mungesë të garancive të barazisë midis kandidatëve;
- Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, në tërësinë e tyre, përbëjnë shkelje të parimeve të shtetit të së drejtës, cenim të barazisë së pjesëmarrësve në konkurrim dhe shkelje të garancive themelore për një proces të rregullt ligjor. Si të tilla, ato çojnë në pavlefshmërinë absolute të aktit përfundimtar (zgjedhjes së shpallur) dhe të gjithë procedurës që i parapriu;
- Mospërmbushjen e kriterëve të meritës – krahasimi i kualifikimeve të kandidatëve;

- *Mosveprimet dhe parregullsitë e lartpërmendura (sidomos mungesa e një rregulloreje të vlerësimit me pikë për kandidatët, dhe anashkalimi i shqyrtimit cilësor të kriterëve statutore) kanë pasur si pasojë që të zbehet çdo dallim meritokracie midis kandidatëve në garë. Me fjalë të tjera, procesi i parregullt e i pambikëqyrur i hapi rrugë një rezultati të padrejtë, pavarësisht diferencave të dukshme në kualifikimet dhe veprimtarinë shkencore të kandidatëve;*
- *Cenimin e Interesit Publik dhe Misionit të Akademisë;*
- *Pengimin e së Drejtës së Aksesit në Drejtësi nga ana e Akademisë;*
- *Shkeljen e Parimeve Kushtetuese dhe Ligjore në Procesin Zgjedhor.”*

Ankuesi referon, ndër të tjera, tek baza ligjore edhe, nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Apelit Administrative, që kanë sanksionuar se shkeljet e rënda të parimit të barazisë në konkurrim apo të procedurave thelbësore çojnë në pavlefshmëri absolute të vendimeve apo akteve përkatëse (pra, aktet e marra në kundërshtim me parimet bazë konsiderohen të pavlefshme ipso jure). Kjo praktikë mbështet kërkesën e paditësit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute në këtë rast, duke qenë se janë cenuar rëndë parimet e barazisë dhe ligjshmërisë procedurale.

Duke cituar respektivisht nga kërkesë-padia se: “Procedura e ndjekur nga Akademia e Shkencave për zgjedhjen e anëtarit të ri ka shkelur parimet themelore kushtetuese të procesit zgjedhor, si dhe vetë legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj. ...Këto parime themelore të procesit zgjedhor – liria e votimit, barazia e kandidatëve dhe fshehtësia e votës – janë pjesë e rendit kushtetues dhe duhet të respektohen nga çdo institucion publik, përfshirë Akademinë e Shkencave.

Përmbledhtas, procesi zgjedhor i zhvilluar nga Akademia e Shkencave ka shkelur: (a) parimin e ligjshmërisë,parimin e barazisë dhe meritës në konkurrim, pasi mënyra e organizimit ka krijuar avantazhe të padrejta dhe ka anashkaluar filtrat normalë të vlerësimit të kandidaturave. Këto shkelje substanciale e bëjnë procesin tërësisht të parregullt dhe të paligjshëm, pavarësisht nëse formalisht është arritur numri i votave për kandidatin e shpallur fitues. Një person i zgjedhur me një procedurë të tillë joligjore nuk mund të konsiderohet i zgjedhur ligjërisht, pasi vetë procesi mbi të cilin mbështetet zgjedhja është i pavlefshëm.”

Bazuar në analizën e deklarimeve të depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, në cilësinë e paditësit, para Gjykatës, ndër të tjera, citohet se, veprimet e ndërmarra nga ana e ASHSH-së, kundrejt dhe në dëm të paditësit Romeo Gurakuqi, sa i takon procedurës së ndjekur për përzgjedhjen e shpalljen fitues të kandidatit për anëtar të Akademisë së Shkencave në fushën e Historisë, zhvilluar më datë 14 korrik 2025, janë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, ku garantohet

mbrojtja e parimit të barazisë, ndër të cilat citohet dhe neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, cili parashikon se:

“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”

Në thelb qëndrimi i ankuesit dhe argumentat e parashtruara pranë KMD-së, lidhen me pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë në konkurim, konkretisht për trajtim të pabarabartë me konkurentin, z. H. K, i cili sipas ankuesit nuk zotëron një status profesional, formim akademik, apo produkt shkencor, në tërësinë e tij, që të ishte i krahasueshëm me të tijn, dhe që nuk përmbushte as kriteret e përcaktuara në pikën 4/2, të thirrjes së shpallur nga ASHSH, për këtë vend vakant.

Komisioneri vëren se, barazia në parim (por dhe në një proces konkurimi, si në rastin konkret) nënkupton që të gjithë personat duhet të trajtohen njësoj, për sa kohë ndodhen në kushte e rrethana të njëjta apo të ngjashme. Mosdiskriminimi është mekanizmi që siguron që kjo barazi të mos cenohet për shkak të karakteristikave personale të personave. Pra, në këtë logjikë, nuk mund të ketë barazi pa mosdiskriminim, dhe çdo formë diskriminimi është një shkelje e barazisë. Këto dy parime, në të drejtën shqiptare dhe atë ndërkombëtare janë të sanksionuara si të ndërlidhura mes tyre.

Kushtetuta e Shqipërisë, si dhe GJEDNJ- në jurisprudencën e saj, kanë konsoliduar interpretimin se, çdo trajtim i pabarabartë pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm është diskriminim, si dhe ka trajtuar barazinë dhe mosdiskriminimin si një *unitet konceptual*, ku shkelja e njëres nënkupton automatikisht shkeljen e tjetrës

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, parimi i barazisë është *qëllimi*, ndërsa parimi i mosdiskriminimit është *mjeti* për ta arritur atë. Juridikisht, ato janë të pandara: çdo dispozitë që garanton barazinë duhet të përmbajë mekanizma për të ndaluar diskriminimin, dhe çdo dispozitë kundër diskriminimit ka si objektiv barazinë.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm, në shkelje të parimit të barazisë në garë, krahasur me konkurentin tjetër z. H. K, nga ana e ASHSH-së, lidhur me procesin e zgjedhjes dhe shpalljes së kandidatit fitues (Z. H. K) në procedurën e konkurimit, të zhvilluar më datë 14 korrik 2025, për përzgjedhjen e anëtarit të ASHSH-së, në fushën e Historisë, dhe ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së konkurimit për përzgjedhjen e anëtarit të ASHSH-së, në fushën e Historisë, zhvilluar më datë 14 korrik 2025, konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit të Zgjedhjeve të ASHSH-së që ka shpallur fitues kandidatin H. K, si dhe detyrimin e ASHSH-së, për përsëritjen e procesit të konkurimit për vendin vakant në fushën e Historisë, duke investuar kështu

njëherësh edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime, fakte e prova, që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Ndër të tjera, në kërkesë-padinë drejtuar Gjykatës, nga ankuesi, theksohet se: “... *Praktika gjyqësore – Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Apelit Administrative ka sanksionuar se shkeljet e rënda të parimit të barazisë në konkurrim apo të procedurave thelbësore çojnë në pavlefshmëri absolute të vendimeve apo akteve përkatëse (pra, aktet e marra në kundërshtim me parimet bazë konsiderohen të pavlefshme ipso jure). Kjo praktikë mbështet kërkesën e paditësit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute në këtë rast, duke qenë se janë cenuar rëndë parimet e barazisë dhe ligjshmërisë procedurale.*

....

Përmbledhtas, procesi zgjedhor i zhvilluar nga Akademia e Shkencave ka shkelur: (a) parimin e ligjshmërisë, duke zbatuar procedura të paautorizuara nga ligji apo statuti; (b) parimin e votës së fshehtë dhe të lirë, duke lejuar praktika që kompromentojnë sekretin dhe autonominë e votës; (c) parimin e barazisë dhe meritës në konkurrim, pasi mënyra e organizimit ka krijuar avantazhe të padrejta dhe ka anashkaluar filtrat normalë të vlerësimit të kandidaturave. Këto shkelje substanciale e bëjnë procesin tërësisht të parregullt dhe të paligjshëm, pavarësisht nëse formalisht është arritur numri i votave për kandidatin e shpallur fitues. Një person i zgjedhur me një procedurë të tillë joligjore nuk mund të konsiderohet i zgjedhur ligjërisht, pasi vetë procesi mbi të cilin mbështetet zgjedhja është i pavlefshëm.”

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete

gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykatat administrative, të cilat vendosin përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë paraqitur si në juridiksionin administrativ, ashtu dhe në atë gjyqësor.

Juridiksioni dhe kompetencat e KMD-së janë të ndryshme e të ndara nga juridiksioni e kompetencat e Gjykatës Administrative. Interferimi, dublimet, mbivendosjet e fakteve të një çështjeje, si në gjykimin administrativ, ashtu edhe para KMD-së, përbëjnë cenim të parimit të ndarjes së pushteteve. Nuk mund të bëhet trajtimi i të njëjtës lëndë (çështje), si nga gjykata administrative, ashtu dhe nga KMD.

Në këtë rast, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe ligji, i kanë dhënë përparësi gjykimit gjyqësor. Të gjithë problematikat që ankuesi ka paraqitur në ankesën e tij në KMD, mbulohen nga kërkesë-padia, baza ligjore dhe arsyetimi i bërë para Gjykatës Administrative, e cila është Gjykatë e specializuar, të cilës ligji *“Për funksionimin dhe organizimin e gjykatave administrative”*, Kodi i Procedurave Administrative, K. Pr. Civile, i ka dhënë të gjithë kompetencat e mjetet ligjore për trajtimin e problematikave në lidhje me procesin zgjedhor dhe vendimmarrjen përkatëse, për zgjedhjen e anëtarit të ASHSH-së.

Ankuesi, në gjykatë ka paraqitur tablo të plotë e shteruese të të gjithë procesit që është zhvilluar për zgjedhjen e anëtarit të ASHSH-së, dhe problematikat ligjore që e kanë shoqëruar, sipas pretendimit të tij, e ku, ndër të tjera ka paraqitur si problematikë edhe mosrespektimin e parimit të barazisë, i cili në thelb ngre dhe është i lidhur me çështje të diskriminimit.

Në nenin 17³, të K. Pr. Administrative, parashikon se: “*Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.*”

Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.

Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.”

Ankuesi, përveç kontestimit të procesit zgjedhor të votimit, në gjykatë ka kërkuar edhe: “*Konstatimin e pavlefshëmrisë absolute të vendimit të komisionit zgjedhor të ASHSH-së,*” i cili, duke shpallur fitues kandidatin H. K, nuk ka konstatuar problematika në procesin zgjedhor.

Sipas nenit 21, të K. Pr. Administrative, parashikohet se: “*Veprimtaria administrative i nënshtrohet:*
a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;

b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe/ose

c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.”

Në përputhje me nenin e mësipërm, përderisa ligji⁴ nuk ka parashikuar organ më të lartë administrativ për ankimimin e vendimeve të Komisionit Zgjedhor të ASHSH-së, me të drejtë ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative, për zgjidhjen e kërtimeve të tij, ku në substancë përfshihen edhe pretendimet e tij për diskriminim.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “*...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 167 Regj., datë 28.07.2025, të z. R. G, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj⁵.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “*Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë*

³ Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.

⁴ Ligji për Akademinë e Shkencave dhe as Statuti i ASHSH-së, nuk kanë parashikuar një organ tjetër administrativ apo se ku, kundërshtohen vendimet e Komisionit Zgjedhor të ASHSH-së.

⁵ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, datë 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.

të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁶, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

- Lidhur me pretendimin e palës ankuese përsa i takon moskthimit përgjigje të kërkesave të tij, mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar prej tij, si: *dokumentacionin dhe provat lidhur me procedurën e zgjedhjes së anëtarit të ri, procesverbalet e mbledhjes zgjedhore, listat e pranisë dhe votimit, korrespondencën me anëtarët për votimin me postë, fletët e votimit (zarfe/fletë), videot e regjistrimit të procesit dhe çdo akt tjetër relevant, etj*”;

Ky kërkim i z. G nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi Komisioneri vëren se, ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, sa i takon pretendimit të tij për mosdhënie të informacionit e dokumentacionit të kërkuar në mënyrën e duhur dhe të plotë.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesi mund t’i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 167 Regj., datë 28.07.2025, të paraqitur nga subjekti ankues, R. G, kundër Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

⁶ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA